



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 08.04.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR GAZSJELLËSIN TRANS
ADRIATIK (PROJEKTI TAP)

Në mbështetje të neneve 6, 70/8, 70/11 dhe 79 të Ligjit nr. 10 119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, neneve 5.4 dhe 28.6 të Marrëveshjes së datës 5 prill 2013 me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nepërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik, sikurse ratifikuar me Ligjin Nr. 116/2013, datë 15.4.2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”; Vendimit Nr. 502, datë 13.07.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 2, datë 20.12.2012 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e projektit TAP si Çështje me Rëndësi Kombëtare në Planifikimin e Territorit”, Vendimit Nr. 1, datë 04.07.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,



VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) për shoqërinë “Trans Adriatik Pipeline AG”.
2. Të bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes Zhvillimore Komplekse
 - b. Materiali i plotë grafik i Lejes Zhvillimore Komplekse
3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë të lëshojë dokumentin e Lejes Zhvillimore Komplekse për çdo fazë të zhvillimit të projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).
4. Dokumenti i Lejes Zhvillimore Komplekse për secilën fazë zhvillimi, i jepet subjektit kërkues vetëm pas plotësimit të pikave si më poshtë:
 - a. paraqitjes së informacionit mbi marrëdhëniet e pronësisë,
 - b. paraqitjes së informacionit të përdorimit të tokës për sipërfaqet që preken nga projekti,
 - c. paraqitjes së dokumentacionit të detajuar teknik (për çdo fazë zhvillimi),
 - ç. pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (për çdo fazë zhvillimi).
5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të lëshojë Lejen e Përdorimit, në përfundim të procesit të zhvillimit, për secilën fazë zhvillimi të Projektit TAP.
6. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT